

IMAM ES-SA'DI

NGA TEFSIRI I SA'DIT

# HISTORIA E MERJEMES

Historia e Merjemes me Isanë,  
alejhimes-selam, nga shpjegimi i  
ajeteve 16-40 të sures Merjem



ESSUNNEH.COM



Titulli: "Historia e Merjemes, alejhes-selâm"  
Autori: Imam AbdurRahman es-Sa'di  
Burimi: Tefsiri i Sa'dit, surja Merjem, ajetet 16-40  
Përktheu: Blerand Grubi



© essunneh.com  
1442H - 2020



بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ  
Bismil-lâhir-Rahmânir-Rahim



All-llahu i Lartësuar ka thënë:

وَأذْكَرُ فِي الْكِتَابِ مَرْيَمَ إِذِ انْتَبَذَتْ مِنْ أَهْلِهَا مَكَانًا شَرْقِيًّا (16) فَاتَّخَذَتْ مِنْ دُونِهِمْ حِجَابًا فَأَرْسَلْنَا إِلَيْهَا رُوحَنَا فَتَمَثَّلَ لَهَا بَشَرًا سَوِيًّا (17) قَالَتْ إِنِّي أَعُوذُ بِالرَّحْمَنِ مِنْكَ إِنْ كُنْتَ تَقِيًّا (18) قَالَ إِنَّمَا أَنَا رَسُولُ رَبِّكِ لِأَهَبَ لَكِ غُلَامًا زَكِيًّا (19) قَالَتْ أَنَّى يَكُونُ لِي غُلَامٌ وَلَمْ يَمَسِّنِي بَشَرٌ وَلَمْ أَكُ بَغِيًّا (20) قَالَ كَذَلِكَ قَالَ رَبُّكَ هُوَ عَلَيَّ هَيِّئٌ وَلَنَجْعَلَنَّ آيَةً لِلنَّاسِ وَرَحْمَةً مِنَّا وَكَانَ أَمْرًا مَقْضِيًّا (21)

**16. Dhe trego (o Muhamed) në Libër për Merjemen, kur u tërhoq nga familja e saj në një vend në lindje,**

**17. duke vënë një perde mes saj dhe atyre. Ne i dërguam Shpirtin Tonë (Xhibrilin), i cili iu paraqit asaj si një njeri i plotë.**

**18. Ajo i tha: “Unë kërkoj nga i Gjithëmëshirshmi të më mbrojë prej teje; nëse i frikësohesh All-llahut!”**

**19. Ai tha: “Në të vërtetë, unë jam vetëm një i dërguar i Zotit tënd, që të të dhuroj ty një djalë të pastër.”**

**20. Ajo tha: “Si mund të kem unë djalë, kur asnjë mashkull nuk më ka prekur e nuk jam as e shthurur?!”**

**21. Iu përgjigj: “Kështu është! Zoti yt ka thënë: ‘Kjo për Mua është e lehtë. Ne do ta bëjmë atë shenjë për njerëzit dhe mëshirë nga ana Jonë’. Dhe kjo është punë e kryer.”**





## Tefsiri (shpjegimi):

Pasi e përmend historinë e Zekeriasë me Jahjanë, si pjesë të mrekullive të jashtëzakonshme, All-llahu kalon te një histori tjetër edhe më e çuditshme, me një shkallëzim ngjitës, prej atyre më pak tek ato më shumë të çuditshmet, dhe thotë:

«**Dhe trego në Librin**» e Lartësuar «**për Merjemen**» alejhes-selâm... – Dhe kjo është një prej vlerave më të larta dalluese të saj; që emri i saj të përmendet në Kuranin e Madhërishëm, të cilin e lexojnë muslimanët në lindje e perëndim të botës. Në këtë Libër, emri i saj përmendet me fjalët më të bukura dhe me lëvdatat më të çmuara, si shpërblim për veprën e saj të vlershme dhe mundin e saj të plotë. Pra, «**trego në Libër për Merjemen**» për qëndrimin e saj të mirë, kur «**u tërhoq**» d.m.th. u largua «**nga familja e saj në një vend në lindje**» d.m.th. nga ana lindore e vendit të tyre.

«**...duke vënë një perde**» d.m.th. një mbulesë ose pengesë për t'u fshehur nga ata. Qëllimi i këtij largimi dhe i kësaj perdeje ishte që të shkëputej nga njerëzit dhe të veçohej për ta adhuruar Zotin e saj, si dhe për t'iu përlulur Atij me përkushtim të pastër dhe nënshtrim. Ajo me këtë e ka përmbushur Fjalën e All-llahut:

{ وَإِذْ قَالَتِ الْمَلَائِكَةُ يَا مَرْيَمُ إِنَّ اللَّهَ اصْطَفَاكِ وَطَهَّرَكِ وَاصْطَفَاكِ عَلَى نِسَاءِ الْعَالَمِينَ \* يَا مَرْيَمُ  
أَفْنِي لِرَبِّكِ وَأَسْجُدِي وَأُزْكِي مَعَ الرَّاٰكِعِينَ }

“(Kujto) kur engjëjt thanë: “O Merjeme! All-llahu të ka zgjedhur, të ka pastruar dhe të ka parapëlqyer ty mbi të gjitha gratë e botës. O Merjeme! Bindju gjithnjë Zotit tënd! Bëj sexhde dhe përkulu në ruku bashkë me ata që përkulen!” [Âl ‘Imrân, 42-43]

Pastaj ka thënë: «**Ne i dërguam Shpirtin Tonë**», dhe ai është Xhibrili (alejhis-selâm), «**i cili iu paraqit asaj si një njeri i plotë**» d.m.th. si njeri i përsosur, me pamje të bukur dhe formë të mirë, pa asnjë të metë dhe mangësi, sepse ajo nuk do të kishte mundësi ta shihte në formën origjinale (prej engjëlli).

Kur e ka parë Xhibrilin në atë formë, duke qenë ajo e shkëputur nga familja, e veçuar nga njerëzit, e fshehur edhe nga personat më të çmuar – nga familja e vet, ajo është frikësuar se mos është ndonjë burrë që synon t'i bëjë keq e që lakmon pas saj, prandaj i ka kërkuar Zotit që ta mbrojë nga ai, duke thënë:

«**Unë kërkoj nga i Gjithëmëshirshmi të më mbrojë prej teje**» d.m.th. kërkoj



tek Ai strehim dhe i lutem të më ruajë me mëshirën e Tij të mos më bësh keq, **«nëse i frikësohesh All-llahut»** d.m.th. nëse i druhash Atij dhe i ruhesh, mos m'u kundërvë! Kështu Merjemja ka bashkuar dy çështje:

[1] ka kërkuar mbrojtje nga Zoti i saj dhe

[2] ia ka kujtuar personit t'i ketë frikë All-llahut dhe e ka urdhëruar t'i përmbahet takvasë; duke qenë ajo në atë gjendje të vetmisë, rinisë dhe largësisë nga njerëzit, kurse ai me atë bukuri të shkëlqyer dhe formë të përsosur njerëzore. Ai nuk i ka thënë asnjë fjalë të keqe dhe as nuk i është kundërvënë, porse ajo veç është frikësuar. Kjo është shkalla më e lartë ku mund të arrijë ndershmëria e njeriut dhe mënjanimi i sherrit dhe shkaqeve të tij.

Kjo ndershmëri – sidomos kur grumbullohen motivet (e gjynahut) dhe mungojnë pengesat – është prej punëve më të vlershme, prandaj All-llahu e ka lavdëruar Merjemen, duke thënë:

{وَمَرْيَمَ ابْنَتَ عِمْرَانَ الَّتِي أَحْصَنَتْ فَرْجَهَا فَنَفَخْنَا فِيهِ مِنْ رُوحِنَا}

**“... edhe Merjemen, të bijën e Imranit; e cila e ruajti virgjërinë e saj dhe Ne frymë brenda (këmishës së) saj nga shpirti[1] Ynë.”** [Et-Tahrîm, 12]

{وَالَّتِي أَحْصَنَتْ فَرْجَهَا فَنَفَخْنَا فِيهَا مِنْ رُوحِنَا وَجَعَلْنَاهَا وَإِنْتَهَا آيَةً لِلْعَالَمِينَ}

**“(Kujtoje) atë që ruajti virgjërinë e saj; Ne frymë brenda saj nga shpirti Ynë dhe e bëmë atë dhe birin e saj mrekulli për gjithë njerëzit.”** [El-Enbijâ', 91]

Pra, si shpërblim, ruajtjen e nderit të saj All-llahu ia ktheu me një fëmijë, si një nga mrekullitë e All-llahut dhe një i dërguar prej të dërguarve të tij.

Kur Xhibrili pa se ajo është trembur dhe frikësuar, tha: **«Në të vërtetë, unë jam vetëm një i dërguar i Zotit tënd»** – d.m.th.: roli im dhe puna ime është vetëm përmbushja e Mesazhit të Zotit tim lidhur me ty, **«që të të dhuroj ty një djalë të pastër»**. Ky është një përgëzim i madh për lindjen e fëmijës dhe për pastërtinë e tij – kurse pastërtia nënkupton se do të jetë i pastër nga veset e ulëta dhe se do të posedojë veti të lëvdueshme.

---

[1] **“Nga shpirti Ynë”** d.m.th. nga shpirti që është një krijesë e veçantë e Jona (e All-llahut).

**Imam Begaviu** (v. 516H, All-llahu e mëshiroftë) ka thënë: **“Ne frymë brenda saj nga shpirti Ynë...”** – d.m.th.: Ne e urdhëruam Xhibrilin që t'i fryjë në mëngën e këmishës së saj dhe me këtë fryrje e krijuam Mesihun (Isanë) në barkun e saj. Shpirtin e ka përcaktuar si të Tijin (te shprehja: “shpirti Ynë”) si nderim për Isanë (alejhis-selâm).” – Tefsiri i Begaviut, Surja El-Enbijâ', ajeti 91 (sh.p.)



Ajo është çuditur nga ekzistimi i një fëmije pa baba dhe ka thënë: **«Si mund të kem unë djalë, kur asnjë mashkull nuk më ka prekur (me martesë) e nuk jam as e shthurur?!»** - dhe fëmija nuk bëhet ndryshe?!

**«lu përgjigj: “Kështu është! Zoti yt ka thënë: ‘Kjo për Mua është e lehtë. Ne do ta bëjmë atë shenjë për njerëzit”»**, e cila tregon për fuqinë e plotë të All-llahut dhe tregon se asnjë shkak prej shkaqeve nuk vepron në mënyrë të pavarur, por veprimi i tyre (shkaktimi i pasojës) është vetëm nën caktimin e All-llahut - dhe se Ai ua mundëson robërve të shohin thyerjen e ligjeve të natyrës të disa shkaqe të zakonshme, që ata të mos lidhen për shkaqet, por ta kenë gjithnjë parasysh Atë që i ka përcaktuar gjërat dhe që i krijon shkaqet. **«...dhe mëshirë nga ana Jonë»** - domethënë: do ta bëjmë mëshirë nga ana Jonë, ndaj tij, ndaj nënës së tij dhe ndaj njerëzve.

- Për sa i përket mëshirës së All-llahut ndaj Isait, ajo është që All-llahu e ka dalluar me shpalljen e Mesazhit dhe ia ka dhuruar ato mirësi që ia ka dhuruar të dërguarve Ulul-Azëm (me vendosmërinë më të madhe).

- Për sa i përket mëshirës së Tij ndaj nënës së Isait, ajo është krenaria, lëvdatat e bukura dhe dobitë e mëdha që i kanë ndodhur.

- Kurse për sa i përket mëshirës së All-llahut ndaj njerëzve, ajo është që dhuntia më e madhe e All-llahut ndaj tyre është dërgimi i një të dërguari tek ata, për t’ua lexuar shpalljet e Tij, për t’i pastruar moralisht e për t’ua mësuar Librin dhe Urtësinë; që ata të besojnë e t’i bindjen dhe kështu ta fitojnë lumturinë e dynjasë dhe Ahiretit.

**«Dhe kjo»** pra ekzistimi i Isait në këtë formë **«është punë e kryer»** - caktim i kaluar, kështu që patjetër do të realizohet ky vendim dhe caktim. Xhibrili (alejhîs-selâm) i ka fryrë shpirtin (e Isait) në mëngën e saj dhe -



فَحَمَلَتْهُ فَانْتَبَدَّتْ بِهِ مَكَانًا قَصِيًّا (22) فَأَجَاءَهَا الْمَخَاضُ إِلَى جِذْعِ النَّخْلَةِ قَالَتْ يَا لَيْتَنِي مِتُّ قَبْلَ هَذَا وَكُنْتُ نَسِيًّا مَنْسِيًّا (23) فَنَادَاهَا مِنْ تَحْتِهَا أَلَا تَحْزَنِي قَدْ جَعَلَ رَبُّكِ تَحْتَكِ سَرِيًّا (24) وَهَزِّي إِلَيْكِ بِجِذْعِ النَّخْلَةِ تُسَاقِطُ عَلَيْكَ رُطْبًا غَنِيًّا (25)

**22. Ajo mbeti me barrë e u tërhoq me të në një vend të largët.**

**23. Dhembjet e lindjes e detyruan atë që të shkonte te trungu i një hurme. Ajo tha: “Ah, sikur të kisha vdekur para kësaj (ngjarjeje) dhe të isha harruar krejt!”**



24. Një zë e thirri nga poshtë: “Mos u pikëlllo, se Zoti yt të ka bërë një burim uji poshtë teje!

25. Shkunde trungun e palmës, që të bien mbi ty hurma të freskëta!



Domethënë, kur mbeti shtatzënë, ajo ndiente frikë nga pasojat e zbulimit, prandaj u largua nga njerëzit «**në një vend të largët**». Kur u afrua lindja, «**dhembjet e lindjes e detyruan atë që të shkonte te trungu i një palme hurme**».

Ngaqë e mundonin dhimbjet e lindjes, dhimbja e izolimit, qëndrimi pa ushqim e pije dhe dhimbja e zemrës nga thashethemet e njerëzve dhe kishte frikë se nuk do të bënte durim, ajo dëshiroi të kishte pas vdekur para kësaj ngjarjeje, të ishte harruar krejt e të mos përmendej. Kjo dëshirë ka qenë për shkak të atij shqetësimi, por në këtë dëshirë nuk ka hair dhe as dobi për të; hairi dhe dobia janë vetëm te caktimi i asaj që ndodhi.

Në atë çast, engjëlli e qetësoi, ia largoi frikën dhe e thirri nga poshtë – ndoshta ka qenë në ndonjë vend më poshtë se ajo – duke i thënë: «**Zoti yt të ka bërë një burim uji poshtë teje!**» që të pish nga ai. «**Shkunde trungun e palmës, që të bien mbi ty hurma të freskëta**», të shijshme e të dobishme.



فَكُلِّيْ وَاشْرَبِيْ وَقَرِّيْ عَيْنًا فَاِمَّا تَرَيَنَّ مِنَ الْبَشْرِ اَحَدًا فَقُولِيْ اِنِّيْ نَذَرْتُ لِلرَّحْمٰنِ صَوْمًا فَلَنْ اُكَلِّمَ الْيَوْمَ اِنْسِيًّا (26)

«Ha, pi dhe qetësohu. Nëse vëren ndonjë njeri, i thuaj: “Unë jam betuar në të Gjithëmëshirshmin se do të agjëroj, prandaj sot nuk do të flas me askënd.”»



«Ha» nga hurmat, «pi» nga burimi «**dhe qetësohu**» duke e shikuar Isanë. Kjo është qetësia e saj, në lidhje me shpëtimin nga dhimbjet e lindjes dhe sigurimin e ushqimit, pijes dhe lehtësimit. Kurse në lidhje me thashethemet e njerëzve, ai e ka urdhëruar që, kur të shohë dikë prej njerëzve, t’i thotë përmes shenjave: «**Unë jam betuar në të Gjithëmëshirshmin se do të agjëroj**» d.m.th. do të hesht, «**prandaj sot nuk do të flas me askënd**.» Domethënë: ‘Mos iu



drejto atyre me fjalë, që të shpëtosh nga fjalët dhe llafet e tyre!’ Tek ata ka qenë e njohur heshtja, si një ibadet i ligjshëm. Në fakt, ajo nuk është urdhëruar të shfaqësohet përpara tyre me fjalë, sepse njerëzit nuk kishin për t’i besuar dhe nuk do të kishte dobi, por edhe që, shfaqësimi i saj përmes fjalëve të Isait në djep, të jetë argumenti më i fortë për pastërtinë e saj. Kjo, ngaqë sjellja e një fëmije pa pasur burrë dhe pretendimi i saj se nuk e ka prekur njeri, do të ishte prej pretendimeve më të mëdha, që, edhe sikur të dëshmonin një numër i madh dëshmitarësh, nuk do ta kishin besuar.

Prandaj, argument që vërteton këtë gjë të mbinatyrshme është bërë një gjë tjetër nga po ai lloj (një gjë e mbinatyrshme gjithashtu) dhe ajo është të folurit e Isait, duke qenë shumë i vogël. Prandaj, All-llahu i Lartësuar ka thënë:



فَأْتَتْ بِهِ قَوْمَهَا تَحْمِلُهُ قَالُوا يَا مَرْيَمُ لَقَدْ جِئْتِ شَيْئًا فَرِيًّا (27) يَا أُخْتَ هَارُونَ مَا كَانَ أَبُوكِ امْرَأَ سَوْءٍ وَمَا كَانَتْ أُمُّكِ بَغِيًّا (28) فَأَشَارَتْ إِلَيْهِ قَالُوا كَيْفَ نُكَلِّمُ مَنْ كَانَ فِي الْمَهْدِ صَبِيًّا (29) قَالَ إِنِّي عَبْدُ اللَّهِ آتَانِيَ الْكِتَابَ وَجَعَلَنِي نَبِيًّا (30) وَجَعَلَنِي مُبَارَكًا أَيْنَ مَا كُنْتُ وَأَوْصَانِي بِالصَّلَاةِ وَالزَّكَاةِ مَا دُمْتُ حَيًّا (31) وَبَرًّا بِوَالِدَتِي وَلَمْ يَجْعَلْنِي جَبَّارًا شَقِيًّا (32) وَالسَّلَامُ عَلَيَّ يَوْمَ وُلِدْتُ وَيَوْمَ أَمُوتُ وَيَوْمَ أُبْعَثُ حَيًّا (33)

**27. Dhe u kthye te populli i vet, duke mbajtur fëmijën. Ata i thanë: “O Merjeme, ke bërë diçka të madhe!**

**28. O motra e Harunit! Babai yt nuk ka qenë njeri i keq, as nëna jote nuk ka qenë grua e shthurur.”**

**29. Ajo bëri me shenjë nga i biri. Ata thanë: “Si t’i flasim ne fëmijës që është në djep?”**

**30. Ai (Isai në djep) tha: “Unë jam rob i All-llahut. Ai më ka dhënë Librin (Ungjillin), më ka bërë profet**

**31. dhe më ka bërë të bekuar kudo që të jem. Ai më ka porositur që të falem e të jap zeqat sa të jem gjallë**

**32. dhe që të jem i mirë ndaj nënës sime dhe nuk më ka bërë arrogant dhe fatmjerë.**

**33. Le të jetë paqja e shpëtimiti mbi mua, në ditën që kam lindur, në ditën që do të vdes dhe në ditën që do të ringjallet!”**





Kur Merjemja u pastrua nga lehonja, shkoi te populli i vet duke e mbajtur Isanë, ngaqë e dinte pafajësinë dhe pastërtinë e vet, prandaj shkoi e çmërzitur dhe e zhbregosur. Ata i thanë: **«ke bërë diçka të madhe»** pra: të rëndë e të keqe! Kanë dashur të thonë: kurvëri – e sa e pastër është ajo nga kjo shpifje!

**«O motra e Harunit!»** Me sa duket, ai është një vëlla i saj i vërtetë, prandaj e kanë përcaktuar si motra e tij. Ata i vënin fëmijëve emrat e profetëve, prandaj nuk do të thotë që e kanë pasur për qëllim Harun ibën Imran-in, vëllanë e Musait, sepse mes tyre ka shumë breza.

**«Babai yt nuk ka qenë njeri i keq, as nëna jote nuk ka qenë grua e shturur.»**

D.m.th.: prindërit e tu kanë qenë punëmirë dhe të pastër nga të këqijat, sidomos nga kjo e keqe – për të cilën aludojnë. Qëllimi i tyre është: ‘Pse ti devijove nga vetitë e tyre dhe solle diçka që s’e kanë bërë ata?!’ – Kështu kanë thënë, sepse pasardhësit, në shumicën e rasteve, i ndjekin të parët për nga mirësia, ose për nga e kundërta. Pra, janë çuditur – sipas paragjykitimit të tyre – se si i ndodhi asaj!

Atëherë, ajo u bëri atyre me shenjë nga Isai: ‘Flisni atij!’ Ajo, në fakt, e bëri këtë shenjë sepse ishte urdhëruar që, kur t’u drejtohet njerëzve, të thotë: **«Unë jam betuar në të Gjithëmëshirshmin se do të agjëroj, prandaj sot nuk do të flas me askënd.»**

Kur ajo u bëri me shenjë që t’i flasin atij, u çuditën dhe thanë: **«Si t’i flasim ne fëmijës që është në djep?»**, sepse kjo nuk është diçka normale dhe nuk i ka ndodhur askujt në atë moshë.

Në atë çast, Isai (alejhis-selâm), duke qenë një foshnjë në djep, tha: **«Unë jam rob i All-llahut. Ai më ka dhënë Librin (Ungjillin), më ka bërë profet»** – u është drejtuar atyre duke e cilësuar veten si ‘rob’ dhe duke ua bërë me dije se nuk ka ndonjë cilësi me të cilën e meriton të jetë i adhuruar, ose “i biri i të Adhurarit”. – All-llahu është i pastër dhe i lartësuar mbi atë që thonë të krishterët, të cilët e kundërshtojnë fjalën e vetë Isait: **«Unë jam rob i All-llahut»**, ndërsa pretendojnë se e pasojnë atë!

**«Ai më ka dhënë Librin (Ungjillin)»** – domethënë: e ka vendosur dhe caktuar që do të më zbresë libër dhe **«më ka bërë profet»**. Pra i ka treguar se ai është një **abd** (rob, i nënshtruar, adhurues) i All-llahut, se All-llahu do t’ia mësojë Librin dhe se do ta bëjë një profet nga profetët e Tij. Këto tregojnë për



përsosurinë e tij si individ, pastaj e ka përmendur përsosurinë e dobisë së tij të tjerët dhe ka thënë: **«dhe më ka bërë 'mubâarak' (me bereqet, të bekuar) kudo që të jem»**, në cilindo vend dhe në cilindo çast. All-llahu ka vënë bereqet në mua, kur ua mësoj njerëzve të mirën, kur i thërras drejt së mirës, kur ua ndaloj të keqen dhe kur i thërras për tek All-llahu me fjalët dhe veprat e mia. Këdo që është takuar me të dhe që është shoqëruar me të, e prekte bereqeti i tij dhe lumturohej nga shoqërimi i tij.

**«Ai më ka porositur që të falem e të jap zeqat sa të jem gjallë»**. Pra, më ka porositur të përmbush detyrimet ndaj Tij, që prej më të mëdhave është namazi, dhe detyrimet ndaj robërve të Tij, që prej më të mëdhave është zeqati (lëmosha). Gjatë gjithë jetës. Që nënkupton: dhe unë do ta përmbush porosinë e Zotit tim dhe do ta çoj në vend. Ai, gjithashtu, më ka porositur të jem i mirë ndaj nënës sime dhe të jem ndaj saj i sjellshëm me maksimumin tim. Unë do të veproj krejt çfarë kërkon mirësjellja ndaj saj, për shkak të fisnikërisë dhe vlerave dalluese të saj, si dhe për shkak se ajo është një prind dhe ka të drejtat e saj, për lindjen dhe për çdo kujdes tjetër.

**«Nuk më ka bërë arrogant»** - mendjemadh ndaj All-llahut, që mbahet me të madh para njerëzve **«dhe fatmjerë»** në dynjanë dhe Ahiretin tim. Nuk më ka bërë të tillë, por më ka bërë të bindur, të nënshtruar e të përvuilur ndaj Tij, modest me robërit e All-llahut dhe fatlumtur në dynja dhe Ahiret. Mua dhe ata që më pasojnë.

Pasi i janë përkryer cilësitë dhe virtytet e lëndueshme, ka thënë: **«Le të jetë paqja e shpëtimi mbi mua, në ditën që kam lindur, në ditën që do të vdes dhe në ditën që do të ringjallem!»** - Domethënë: nga mirësia dhe bujaria e Zotit tim unë kam shpëtuar në ditën e lindjes, në ditën kur të vdes dhe në ditën kur të ringjallem, nga e sherri i shejtanit dhe nga dënimi. Kjo nënkupton se ai ka shpëtuar nga të gjitha situatat tmerruese të Ditës së Ringjalljes dhe nga Bota e Gjynahqarëve (Zjarri) dhe se ai është prej banorëve të Botës së Paqes. Kështu që kjo është një mrekulli e madhe dhe një argument i qartë se ai vërtet është i dërguar i All-llahut dhe rob i Tij.



ذَلِكَ عِيسَى ابْنُ مَرْيَمَ قَوْلَ الْحَقِّ الَّذِي فِيهِ يَمْتَرُونَ (34) مَا كَانَ لِلَّهِ أَنْ يَتَّخِذَ مِنْ وَلَدٍ سُبْحَانَهُ إِذَا قَضَىٰ أَمْرًا فَإِنَّمَا يَقُولُ لَهُ كُنْ فَيَكُونُ (35) وَإِنَّ اللَّهَ رَبِّي وَرَبُّكُمْ فَأَعْبُدُوهُ هَذَا صِرَاطٌ مُسْتَقِيمٌ (36)



**34. Ky është Isai, i biri i Merjemes. Kjo është fjala e vërtetë, për të cilën ata dyshojnë dhe diskutojnë.**

**35. All-llahu nuk ka mbetur të marrë dikë për bir. I Lartësuar është Ai (i pastër nga të metat)! Kur vendos diçka, Ai vetëm thotë për të “Bëhu!” dhe ajo bëhet.**

**36. (Isai tha): “Vërtet, All-llahu është Zoti im dhe Zoti juaj; andaj adhuroni vetëm Atë! Kjo është udha e drejtë”.**



Domethënë: ky që u përshkrua me këto cilësi është Isai, i biri i Merjemes. Nuk ka për këtë kurrfarë dyshimi. Ky është lajm i vërtetë dhe është Fjala e All-llahut. Fjalët e kujt tjetër mund të jenë më të vërteta dhe më të përkryera se Fjalët e All-llahut? Pra ky është një lajm i sigurt bindshëm rreth Isait (alejhis-selâm), kurse çfarëdo fjale që thuhet e që e kundërshton këtë, është prerazi e kotë. Më së shumti që mund të jetë, është të jetë një dyshim i atij që e thotë, për të cilën nuk ka kurrfarë diturie. Prandaj ka thënë: **«për të cilën ata dyshojnë dhe diskutojnë.»** d.m.th. ata dyshojnë dhe polemizojnë me gjëra të dyshimta dhe trillimet e tyre. Disa prej tyre kanë thënë: “Ai është All-llahu!”, disa: “i biri i All-llahut”, disa: “njëri prej treve”... – All-llahu është shumë lart e i pastër nga trillimet dhe shpifjet e tyre.

**«All-llahu nuk ka mbetur të marrë dikë për bir.»** Domethënë: nuk i shkon dhe nuk i takon madhërisë së Tij, sepse kjo është prej gjërave absurde. Ai është i Pasuri, që nuk ka nevojë për askënd, i Lavdishmi, Sunduesi i të gjithë robërve! Si ka mundësi që nga robërit dhe skllëverit e Tij të merr dikë për bir?

**«SubhâneHu»** d.m.th. i Lartësuar është Ai, i pastër nga të pasurit fëmijë dhe të meta! **«Kur vendos një gjë»**, prej gjërave të vogla ose të mëdha, nuk mund të mos realizohet ose të jetë e vështirë për Të. **«Ai vetëm thotë për të “Bëhu!” dhe ajo bëhet.»** Domethënë, kur Caktimi dhe Vullneti i Tij janë plotësisht të zbatueshëm në botën e sipërme dhe botën e poshtme, atëherë si mund të ketë fëmijë? Dhe pasi kur Ai dëshiron diçka, vetëm i thotë: **«“Bëhu!” dhe ajo bëhet»**, pse duhet të llogaritet e pagjasë që ta ketë krijuar Isanë pa baba?!

Prandaj Isai ka treguar se është një rob, nën zotërimin e All-llahut. Si çdo krijesë tjetër. Ka thënë: **«Vërtet, All-llahu është Zoti im dhe Zoti juaj»**, i Cili na ka krijuar, na ka dhënë formën, na ka sistemuar si ka dashur dhe na ka



drejtuar me caktimin e Tij, **«andaj adhuron vetëm Atë!»** D.m.th. kushtojani Atij pastër të gjitha adhurimet tuaja dhe përpiquni fort që të jeni të kthyesëm kah Ai me pendim.

Në këtë fjali vërtetohet Njeshmëria e All-llahut si Zot dhe Njeshmëria e Tij si i Adhuruar, duke u vënë e para si argument për të dytën (pasi Ai është Zoti Një, atëherë vetëm Ai duhet adhuruar – sh.p.). Për këtë ka thënë: **«Kjo është udha e drejtë»**, d.m.th. rruga e drejtë që të çon tek All-llahu, ngaqë kjo është rruga e të dërguarve dhe ndjekësve të tyre. Kurse çdo tjetër është prej rrugëve të devijimit dhe humbjes.



فَاخْتَلَفَ الْأَحْزَابُ مِنْ بَيْنِهِمْ فَوَيْلٌ لِلَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ مَّشْهَدِ يَوْمٍ عَظِيمٍ (37) أَسْمِعْ بِهِمْ وَأَبْصُرْ يَوْمَ يَأْتُونَنَا لَكِنِ الظَّالِمُونَ الْيَوْمَ فِي ضَلَالٍ مُبِينٍ (38)

**37. E megjithatë, grupet u përçanë në lidhje me atë. Mjerë ata që nuk besojnë për takimin e një Dite të madhe (Ditës së Kiametit)!**

**38. E sa mirë do të dëgjojnë e do të shohin atë Ditë, kur do të vijnë te Ne! Por, sot keqbërësit janë në humbje të qartë!**



Pasi e sqaron All-llahu i Lartësuar çështjen e Isait, të birit të Merjemes, për të cilën nuk ka asnjë dyshim, tregon se **«grupet»**, pra sektet e devijuara, si jehudët, të krishterët etj., me të gjitha llojet e tyre, u kundërshtuan dhe u përçanë lidhur me Isanë (alejhis-selâm). Disa e tepruan me madhërimin e tij, disa e nënvlerësuan. Disa thanë: ‘Ai është vetë All-llahu!’, disa thanë: ‘Ai është i biri i All-llahut!’, disa thanë: ‘Ai është njëri prej Trinisë!’ e disa të tjerë, si puna e jehudëve, nuk e llogaritën as të dërguar, por e fyen me shpifjen: ‘bir lavire’! Të gjithë kishin vetëm fjalë të kota dhe mendime të prishura, të cilat bazoheshin mbi dyshime, kokëfortësi, argumente të pavlefshme dhe hutime të dështuara.

Të gjithë këta e meritojnë ndëshkimin e ashpër i cili u kanoset, prandaj ka thënë: **«Mjerë ata që nuk besuan»** në All-llahun, të dërguarit e Tij dhe Librat e Tij – dhe këtu hyjnë jehudët dhe të krishterët, të cilët thanë për Isanë fjalën e kufrit – **«(mjerë ata) për takimin e një Dite të madhe»**, Ditës së Ringjalljes, të cilën e dëshmojnë të parët e të fundit, banorët e qiellit e të Tokës, Krijuesi dhe



krijesat. Ditës, e cila do të jetë plot tërmete dhe tmerre dhe në të cilën do të zhvillohet shpërblimi i veprave. Atëherë do të shihet qartë ajo që e fshihnin dhe ajo që e shpallnin.

**«E sa mirë do të dëgjojnë e do të shohin atë Ditë, kur do të vijnë te Ne»,** do ta pranojnë që kanë mohuar fenë dhe që kanë bërë shirk (i kanë veshur All-llahut ortakë)! Do t'i pranojnë fjalët e tyre e do të thonë: **“O Zoti ynë, pamë dhe dëgjuam, andaj, kthena (në atë botë) që të bëjmë vepra të mira! Ne tashmë besojmë me bindje!”** [Es-Sexhde, 12]

Pra, në Ditën e Ringjalljes ata do ta dinë sigurt se në çfarë gjendje janë.

**«Por, sot keqbërësit janë në humbje të qartë»** - dhe nuk janë të justifikuar për këtë huti, sepse ata, ose ishin të atillë që kundërshtonin me kokëfortësi dhe devijonin me vetëdije; e njihnin të vërtetën por shmangeshin nga ajo, ose ishin të atillë që e humbnin rrugën e vërtetë, duke pasur mundësi ta njihnin të vërtetën dhe të saktën, por të kënaqur me devijimet e veta dhe veprat e këqija, nuk përpiqeshin ta dallonin të vërtetën nga e kota.

Lexoje me vëmendje se si ka thënë: **«Mjerë ata që nuk besuan»**, pas Thënies së Tij: **«grupet u përçanë»!** Nuk ka thënë: **“Mjerë ata!”** se përemri do të vlente për të gjitha grupet, por ka thënë: **«Mjerë ata që nuk besuan»**, sepse, pjesë e atyre grupeve që u përçanë ishte një grup që e kanë qëlluar të vërtetën dhe kanë thënë për Isanë: **‘Ai është rob i All-llahut dhe i dërguari i Tij’**. Ata e kanë besuar dhe e kanë pasuar. Këta janë besimtarë dhe nuk hyjnë nën kërcënimin e përmendur në ajet. Prandaj All-llahu e ka kufizuar kërcënimin mbi **ata që nuk besuan**.



وَأَنْذَرَهُمْ يَوْمَ الْحَسْرَةِ إِذْ قُضِيَ الْأَمْرُ وَهُمْ فِي غَفْلَةٍ وَهُمْ لَا يُؤْمِنُونَ (39) إِنَّا نَحْنُ نَرِثُ الْأَرْضَ وَمَنْ عَلَيْهَا وَإِلَيْنَا يُرْجَعُونَ (40)

**39. Paralajmëroji ata (o Muhamed) për Ditën e Pikëllimit, kur të ketë marrë fund çështja, ndonëse tani ata janë të shkujdesur dhe nuk besojnë.**

**40. Vërtet, jemi Ne që e trashëgojmë Tokën dhe gjithçka që gjendet në të dhe ata te Ne do të kthehen.**





Paralajmërimi do të thotë njoftim për një rrezik, që jepet në mënyrë frikësuese dhe duke i treguar cilësitë e rrezikut. Dhe gjëja më e denjë për t'iu frikësuar dhe për të cilën duhet paralajmëruar është: **Dita e Pikëllimit** (keqardhjes), kur të ketë marrë fund çështja. Dita, kur do të mblidhen të parët e të fundit në një hapësirë të vetme dhe do të merren në llogari për veprat e tyre. Ata që kanë besuar në All-llahun dhe i kanë pasuar të dërguarit e Tij, do të lumturohen me një lumturi, pas së cilës nuk do të mjerohen kurrë. Kurse ata që nuk kanë besuar në All-llahun dhe nuk i kanë ndjekur të dërguarit e Tij, do të mjerohen me një mjerim, pas të cilit nuk do të lumturohen kurrë. Do t'i humbin vetët dhe familjet e tyre. Aty ata do të pikëllohen dhe do të ndjejnë një keqardhje, nga e cila shpirtrat këputen dhe zemrat plasin.

A mund të ketë keqardhje më të madhe se sa ta humbësh kënaqësinë e All-llahut dhe Xhenetin e Tij dhe ta meritosh zemërimin e All-llahut dhe Zjarrin e Tij, dhe atë në një mënyrë që nuk ka kthim prapa, që t'i rifillosh veprat dhe nuk ke asnjë rrugëdalje për ta ndryshuar gjendjen e të kthehesh në dynja! – Kjo është ajo që do t'u vijë. Kurse tani, në dynja, ata janë të shkujdesur lidhur me këtë çështje të madhe, as nuk u shkon mendja. Nëse rastësisht u shkon mendja, nuk e çajnë kokën.

Shkujdesja i ka pushtuar dhe dehja i ka mbërthyer, kështu që nuk besojnë në All-llahun dhe nuk i pasojnë të dërguarit e Tij. Ata i ka joshur dynjaja dhe, mes tyre dhe imanit, u kanë dalë pengesë ëndjet, të cilat kryhen dhe shuhen.

Dynjaja dhe çdo gjë që gjendet në të, që nga fillimi e deri në fund, do të largohet prej banorëve të saj dhe banorët do të largohen prej saj, kështu All-llahu do ta trashëgojë Tokën dhe çdo gjë që gjendet në të. Pastaj tek Ai do të kthehen, do t'i shpërblejë për veprat që i kanë bërë në dynja; për ato që i kanë humbur në të ose që i kanë fituar.

Kush ka vepruar mirë, le ta lavdërojë All-llahun, kurse kush gjen diçka tjetër, le të mos e qortojë askënd, përveç vetvetes!

